



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR
KËSHILLI



VENDIM

Nr 63 datë 28.06.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB Nr 1, Datë 21.01.2016, "PËR MIRATIMIN E PAKETES FISKALE PËR VITIN 2016" i ndryshuar

Bazuar në Ligjin Nr. 139 datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", në Ligjin Nr. 9632 datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", të ndryshuar, në vendimin Nr. 132, datë 7.3.2018 "PËR METODOLOGJINË PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME "NDËRTESTA", E BAZËS SË TAKSËS PËR KATEGORI SPECIFIKE, NATYRËN DHE PRIORITETIN E INFORMACIONIT DHE TË DHËNAVE PËR PËRCAKTIMIN E BAZËS SË TAKSËS, SI DHE TË KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR VLERËSIMIN ALTERNATIV TË DETYRIMIT TË TAKSËS "ne Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar , Udhëzimin e Ministrise se Financave nr. 24 datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, Këshilli i Bashkisë Skrapar duke u mbështetur në materialin e përgatitur nga Grupi i punës :

VENDOSI:

Në paketën fiskale të vitit 2016 miratuar në VKB nr 1, datë 21.01.2016 i ndryshuar në pika b.1 "Taksa mbi Ndërtesat" ndryshohet si më poshtë:

Për efekt të llogaritjes të taksës mbi ndërtesën/njësi pronësie Bashkia Skrapar ndahet në tre zona.

ZONA 1.
Qyteti Çorovodë



ZONA 2

Fshatrat ; Çerenisht , Sharovë , Munushtir, Orizaj , Bogovë.

ZONA 3

Të gjithë fshatrat e tjerë në territorin e Bashkisë Skrapar

b.1.1. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim ne Bashkine Skrapar:

b.1.1 Shkalla e taksës në përqindje (%) të jetë si më poshtë:

ZONA 1 = 0.050 %

ZONA 2 = 0.04 %

ZONA 3 =0.035 %

- Për gratë kryefamiljare të divorcuara shkalla në përqindje e taksës mbi ndërtesen të jetë:

ZONA 1 = 0.035 %

ZONA 2 =0.035 %

ZONA 3 =0.035 %

